Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 95-të të mbajtur më 15.11.2023, ka miratuar sa vijon.

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-5127/1 nga 15.11.2021, me pretendime për shkelje të dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës nga ///, ish-kryetar i Komunës ///, gjatë kohëzgjatjes së mandatit, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë sepse ka konsideruar se autoriteti tjetër është kompetent për të vepruar.

Lënda me numër 12-5127/1 nga 15.11.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Më datë 15.11.2021 është dorëzuar denoncim nga një parashtrues i njohur - ///, kryetar aktual i Komunës ///, me pretendime për shkelje të dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës nga ///, ish-kryetar i Komunës / // gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij dhe është konstatuar lënda me numër 12-5127/1, datë 15.11.2021.

Në denoncim, parashtruesi thekson se dy zyrtarë të administratës komunale të cilët janë punësuar përmes një agjencie private të punësimit, gjatë mandatit të kryetarit të mëparshëm të Komunës ///, për një periudhë nëntë mujore, kanë punuar me orar të plotë ( jashtë orarit) në kohëzgjatje prej 312 orësh ose 304 orësh, me urdhër të ish-kryetarit të Komunës/// ///.

Parashtruesi i denoncimit konsideron se është shkelur neni 117 i Ligjit për Marrëdhëniet e Punës dhe kërkon që KSHPK-ja të konstatojë të njëjtën gjë, pas së cilës do të inicohet procedura në pajtim me ligjin.

Njëkohësisht, parashtruesi bën me dije se Komuna -------- i është drejtuar tashmë Inspektoratit Shtetëror të Punës në lidhje me rastin në fjalë, nga i cili ka kërkuar kryerjen e një inspektimi të jashtëzakonshëm.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në denoncim, Inspektorati Shtetëror i Punës ka konstatuar se pretendimet kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, për të cilat autoriteti kompetent për të vepruar është Inspektorati Shtetëror i Punës. Duke qenë se për rastin tashmë është njoftuar Inspektorati Shtetëror i Punës, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij Vendimi.

Dorëzuar:
- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: A.R.M.
Miratoi: Mr.V.G anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
**Kryetar,**
**Biljana Ivanovska**